



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

Data: 27.3.2023

Nr: 209

Ora: 14:00

V E N D I M

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT PËR AGJENTËT TELEFONIKË NË DITËN E
ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 14, pika 2, nenit 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I N:

1. Agjentët telefonikë, në ditën e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, përfitojnë shpërblim në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.
2. Efekti financiar sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2023, për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Lealba PELINKU

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI